



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2020:125289

Datë: 23.02.2021

Numri i dokumentit: 01533455

PKR.nr.195/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti për Krime të Rënda, gjyqtari Shaqir Zika, Kryetari i trupit gjykues me pjesëmarrjen e Sekretares Juridike procesmbajtësen Nushe Kadrija, në lëndën penale kundër të akuzuarit D. G. E. nga fshati . . . , Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale: lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.6 dhe par.1 KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i akuzuar me aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë –Departamenti për Krime të Rënda, PP/L.nr.111/2020, të datës 15.10.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 10.02.2021 në prezencën e Prokurores së shtetit Ardita Beqiraj- Hyseni, të akuzuarit si dhe të dëmtuarit A. Rr. së bashku me përfaqësuesin ligjor të atin S. Rr., me datë **10.02.2021** mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 23.02.2021 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D. E., i biri i G. , e ëma S., e gjinisës Q, data e lindjes . . . në Gjakovë, me banim në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, i martuar, atë i një fëmije, ka të kryer shkollën fillore, me profesion kuzhinier, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

I. Me datën 27.04.2020, rreth orës 15:20 minuta, në fshatin . . . , Komuna e Gjakovë, nga pakujdesia me armë i shkakton lëndim të rëndë trupor, të dëmtuarit A. Rr., në atë mënyrë që përderisa i pandehuri së bashku me të dëmtuarin dhe dëshmitarin B. B., që të tre shokë, ndodheshin para dyerve të oborrit të shtëpisë së të pandehurit dhe ky i fundit ishte duke gjuajtur shpezët me një pushkë ajrore model “N-01”, prodhim Turk, me numër serik 154600, e kalibrit 4.5 mm, ashtu që i pandehuri në një moment duke menduar se pushka është e zbrazur, në shenjë humori gjuan në drejtim të të dëmtuarit dhe plumbi i shkrepur e godet në këmbën e majtë, i cili menjëherë dërgohet për ndihmë mjekësore fillimisht në QKMF në Junik, e më pas në Spitalin Rajonal të Gjakovës, me çrrastë nga plaga e marrë i dëmtuari pëson dëmtime të rënda trupore më afër të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr.N. U. të datës 16.09.2020.

-Me këto veprime ka vepër penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.6 dhe par.1 KPRK-së.

II. Më par ka siguruar dhe gjerë me datën 27.04.2020, në fshatin . . ., Komuna e Gjakovës, pa autorizim, ka poseduar armë dhe municion në kundërshtim me nenin 4 par.1 nënpar.1.1 të Ligjit për Armë të Republikës së Kosovës, të cilat me ligj kategorizohen si armë të ndaluara dhe atë me një (1) pushkë ajrore e prodhimi Turk model “N-01”, me numër serik 154600, kalibrit 4.5 mm, ku e njëjta armë nga pakujdesia i shkakton lëndime të rënda trupore të dëmtuarit A. Rr., ku e njëjta armë dhe një paketim fishekë janë konfiskuar nga ana e policisë në vendin e ngjarjes.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale: mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, dhe nenit 186 par.3.1 lidhur me par.6 dhe par.1, nenit 366 par.1 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 dhe 366 të KPPK-se, të akuzuarin e :

G J Y K O N

- Për veprën penale në dispozitivin I të akuzës për vepër penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.6 dhe 1 të KPRK-së, ME DENIM ME KUSHT duke i a vërtetuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

- Për vepër penale mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-se, ME DENIM ME KUSHT duke i a vërtetuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 2 (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Në bazë të nenit 76 të KPRK-së, i shqipton:

DËNIMIN UNIK ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18)muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej dy (2) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Ndaj të akuzuarit D. E. i **konfiskohet**: një (1) pushkë ajrore e prodhimi Turk model “N-01”, me numër serik 154600, kalibrit 4.5 mm, si objekte të veprës penale.

Urdhërohet Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e armës të konfiskuar, që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2020-EA-0464.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit A. Rr., i ati S. Rr., nuk ka parashtruar kërkesë pasurore-juridike.

I akuzuari është liruar nga pagesa e shpenzimeve procedurale si dhe taksës së kompesimit të viktimave të krimit pasi që i njëjti është përfitues i ndihmës sociale në bazë të kartelës të ndihmës sociale të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Gjakovë me numër regjistrimit 46355.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm tani Departamentit për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate, ka ngritur aktakuzën me numër PP/I.nr.111/2020, të datës 15.10.2020, kundër të akuzuarit D. E. nga fshati . . ., Komuna Gjakovë, për shkak të veprës penale: lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.6 dhe par.1 KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestare me datë 10.02.2021, ku prezent ka qenë përfaqësuesja e akuzës Prokurorja e Shtetit Ardita Beqiraj- Hyseni, i akuzuari D. E., i dëmtuari A. Rr. së bashku me përfaqësuesin ligjor të atin S. Rr..

Pas leximit të aktakuzës në seancën e shqyrtimit fillestarë, Gjykata është bindur se të akuzuarit kanë kuptuar aktakuzën, iu është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë.

Me këtë rast Gjykata ka udhëzuar të akuzuarit për rendësin dhe pasojat e pranimit të fajësisë, kështu që pas shpjegimeve të bëra nga Kryetari i Trupit Gjyqësor, të akuzuarit kanë deklaruar se: e pranojnë fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, kjo i ka ndodhur nga pakujdesia, ngase me këtu të dëmtuarin A. është shokë i ngushtë dhe të njëjtit kanë gjuajtur me pushkë ajrore shpezë, armën e kam shkrep nga pakujdesia dhe e kam lënduar shokun tim dhe menjëherë i kam dhanë ndihmë, e kam dërguar në ambulancë në Junik e më. Pastaj në Spitalin e Gjakovës, familja e të dëmtuarit rastin ma ka falur, i kam kërkuar falje, i kam shprehur keqardhjen e thellë, dhe tani i kemi marrëdhëniet e mira dhe gjendjen ekonomike e kam shumë të vështirë, jam i pa punë, jetoj nga ndihma sociale, jam mbajtës i vetëm i familjes, jam atë i një fëmije andaj i propozoi gjykatës që të më shqiptoi një dënim sa më të butë të paraparë me ligj dhe premtoi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme penale.

Pas deklarimit të akuzuarit D. E., për pranimin e fajësisë, Kryetari i trupit gjyqësor kërkoj që mendimin e vet ta jep Prokurorja e Shtetit.

Prokurorja e shtetit Ardita Beqiraj Hyseni duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë deklaroi se: pajtohem me pranimin e fajësisë të bërë sot nga ana e të pandehurit për veprat penale për të cilat akuzohet meqenëse një pranim i tillë i fajësisë u bë konform dispozitave ligjore dhe po ashtu ka mbështetje të plotë në provat të cilat ndodhen në shkresat e lëndës andaj gjykatës i propozoi që këtë pranim të fajësie të bërë nga ana e të pandehurit ta aprovoi.

I dëmtuari A. Rr. deklaron se: me këtu të pandehurin është shok dhe se rasti ka ndodhur nga pakujdesia dhe unë raportet me të pandehurin si para rastit dhe pas rastit i kam të mira dhe të njëjtit ia kam falur rastin.

Përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit i ati i tij S. Rr. deklaron se nuk i bashkëngjitet ndjekje penale dhe nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike, me familjen e të pandehurit qe 20 vite njihemi, kemi hyrje dalje dhe të njëjtit menjëherë pas rastit gjersa djali imë ka qenë në spital rastin ia kam falur.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, kryetari i trupit gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë kryetari i trupit gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, dhe atë deklarata e të dëmtuarit A. Rr., dhënë në prokurori me datë 08.10.2020, raporti i oficerit policor A. L., vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të datës 27.04.2020, raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes të datës 27.04.2020, raporti mjekësor i spitalit rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë me numër 5605 të datës 27.04.2020, ekspertiza mjeko-ligjore e përpiluar nga Dr. N. U., ekspert mjeko-ligjor datës 16.09.2020 si dhe nga foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, andaj të gjitha këto vërtetojnë rrethanat për gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin I dhe II të këtij aktgjykimi, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë kryetari i trupit gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se i akuzuari D. E., nga pakujdesia ka kryer veprën penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.6 dhe par.1 të KPRK-se, në kohën, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv I të këtij Aktgjykimi, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv II të këtij Aktgjykimi dhe me këto veprime përmbushen- krijohen elementet e veprës penale lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.6 dhe par.1 KPRK-së, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit se është i moshës së re, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit që në shqyrtimin fillestar për veprat penale për të cilat ngarkohet, si dhe faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale, po

ashtu i njëjti është i gjendjes së varfër ekonomike, jeton nga ndihma sociale, i dëmtuari nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitivet e këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së dhe se dënimi i shqiptuar me kusht sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedoni akuzuari dhe se me dënimin e shqiptuar do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitim i tij, do të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi konfiskimin e armës

Gjykata ndaj të akuzuarit D. E. nenit 366 paragrafi 3 të KPRK-së, ka konfiskuar amën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi si objekt i veprës penale dhe më pas ka urdhëruar Stacionin Policorë në Gjakovë që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e armës.

Vendimi mbi lirimin nga shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor pasi që i pandehuri është përfitues i ndihmës sociale bazohet në dispozitat e nenit 453 par.1 lidhur me par.4 të KPRK-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i përgjithshëm - PKR.nr.195/20, me datë 23.02.2021

**Sekretare juridike,
Nushe Kadrija**

**Kryetari i trupit gjykues,
Shaqir Zika**

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.